

DHUNA NË FAMILJE

Dhuna në familje mund të përkufizohet si një grup sjelljesh që synojnë kontrollimin e të tjerëve përmes përdorimit të forcës, frikësimit dhe manipulimit. Një përkufizim i tillë i dhunës mund të zbatohet në të gjitha format e dhunës në familje - abuzim fizik, abuzim psikologjik, abuzim seksual, material dhe abuzimi në punë. Në shumicën e rasteve, viktimat janë gratë, fëmijët dhe të moshuarit. Dhuna mund të jetë e dy natyrave: Aktiv: personi vuan nga abuzimi fizik, psikologjik, seksual ose ekonomik dhe Pasiv: i referohet braktisjes së personit i cili nuk mund të kujdeset për veten e tij.

SI MUND TË PARANDALOHJË DHUNËN NË FAMILJE?

- Lajmërimi i policisë (192)
- Organizimi dhe pjesëmarrja në fushata ndërgjegjësuese
- Shpërndarja e informacionit në lidhje me format e dhunës, pasojat e saj dhe mënyrën e veprimit kundër saj
- Vini në dyshim dhunën, si një mënyrë të dobishme për të zgjidhur konfliktet
- Trajnimi për personelin shëndetësor, forcat e sigurisë, shërbimet sociale, avokatët dhe gjyqtarët - për tu përballur me rastet e dhunës
- Merrni iniciativën për të pyetur për dhunën, por asnjëherë në prani të partnerëve, anëtarëve të familjes dhe miqve, etj.

ÇKA NDIHMON NË PARANDALIMIN E

DUKURIVE NEGATIVE

**NDERSHMËRIA
PËRGJEGJËSIA
NJOHJA E LIGJEVE
TRANSPARENCA
DREJTËSIA
SUNDIMI I LIGJIT**

**DUKE RESPEKTUAR LIGJIN, UNË KONTRIBUOJ
NË NDËRTIMIN E SHTETIT TË SË DREJTËS**



Organizata për Zhvillim të Komuniteteve

SË BASHKU KUNDËR DUKURIVE NEGATIVE NË KOSOVË

Lufta kundër

DUKURIVE NEGATIVE

**fillon nga
TI!**



Kjo fletushkë është shtypur në kuadër të projektit:

“Fuqizimi i lidhjeve në mes të Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Publike për promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë”.

Financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë dhe implementuar nga OJQ “HUMAN” në bashkëveprim me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Institucionet Publike në komunat Pejë, Gjakovë, Deçan, Junik, Istog dhe Klinë.



BULLIZMI

Bullizëm janë ato situata kur një fëmijë ose grup fëmijësh, duke përfituar nga forca/ fuqia, pushteti që ata mund të kenë, përbuzin, fyejnë, refuzojnë, përjashtojnë, kërcënojnë, godasin një fëmijë apo një grup tjetër fëmijësh “më të dobët” se ata në mënyrë të përsëritur, duke ju shkaktuar dëmtime fizike apo lëndime serioze të mirëqenies psiko/emocionale

Mënyrat e shfaqjes: Thirrja e dikujt me emra fyes, tallës, shkrimi i mesazheve lëndues, lënia jashtë aktiviteteve, kërcënimi, të bërtiturit, frikësimi, vjedhja ose dëmtimi i sendeve/gjërave të tyre personale, goditja, shkelmimi, pickimi i tyre, etj.

Llojet e bullizmit: Bullizmi verbal, bullizmi fizik, bullizmi kibernetik, bullizmi social, bullizmi i shkruar.

SI MUND TË PARANDALOJMË BULLIZMIN?

- RAPORTIMI I MENJËHERSHËM I BULLIZMIT: MOS HESHT!
- INKURAJIMI I FËMIJËS/NXËNËSIT TË FLASË, DËGJIMI ME VËMENDJE, TREGOHUNI VAZHDIMISHT MIRËKUPTUES DHE MBËSHTETËS NDAJ SHQETËSIMIT TË TIJ
- DREJTIMI TEK PSIKOLOGU I SHKOLLËS APO KUJDESTARI
- DISKUTIMI RRETH BULLIZMIT
- MOS I MERRNI GJËRAT NË DUART TUAJA DHE TË PËRBALLENI ME DHUNUESIN OSE PRINDËRIT E TIJ/SAJ
- NDËSHKIMI PENAL I BULLIZUESVE
- NGRITJA E GRUPEVE MBËSHTETËSE PËR TË ADRESUAR NEVOJAT DHE PROBLEMET QË VIJNË NGA BULLIZMI
- NXITJA E FËMIJËVE TË SHOQËROHEN ME SHOKË E SHOQE

NARKOTIKËT APO DROGAT

Çfarë janë drogat? Teknikisht, drogat janë lëndë kimike të cilat ndikojnë në funksionimin normal të trupit dhe/ose të trurit. Drogat turbullojnë aftësinë gjyquese të përdoruesve të tyre, rritet oreksi dhe puls, përdoruesi ka probleme edhe me kryerjen e akteve fizike dhe intelektuale, shpejtimin e frymëmarrjes dhe rritjen e temperaturës së trupit dhe të rrahjeve të zemrës. Përdoruesit mund të sillen në mënyrë shumë të çuditshme dhe të parregullt dhe, ndonjëherë edhe në mënyrë të dhunshme, madje varësisht nga lloji i drogës, nga mbidoza mund të vijë edhe deri të vdekja e përdoruesit.

Drogat janë substanca të ndaluara dhe të dënueshme me Kodin Penal të Kosovës.

SI MUND TË PARANDALOJMË PËRDORIMIN E NARKOTIKËVE DHE TË EDUKOJMË TË RINJTË LIDHUR ME DROGAT?

- EDUKIMI MBI TEMËN E DROGËS
- MBIKQYRJA PRINDËRORE DHE E MËSIMDHËNËSVE NDAJ FËMIJËVE-TË RINJËVE
- LAJMËRIMI NË POLICI I TREGTARËVE TË DROGËS
- BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET SHËNDETËSORE
- FUSHATAT VETËDIJËSUESE PËR PASOJAT E NARKOTIKËVE
- TË KËRROHET NDIHMË TE PSIKOLOGU DHE PUNONJËSI SOCIAL I SHKOLLËS
- ORGANIZIMI DHE PJESËMARRJA NË AKTIVITETE SPORTIVE DHE REKREATIVE, ETJ.

DHUNA NË SHKOLLA

Dhuna ndërmjet nxënësve është një formë e sjelljes agresive në të cilën dikush qëllimisht dhe në mënyrë të përsëritur i shkakton lëndim ose shqetësim një personi/nxënësi tjetër. Prandaj shkolla duhet të jetë një mjedis i sigurt dhe siguria në shkolla paraqet një çështje prioritare, krahas edukimit dhe arsimimit.

FAKTORËT QË NDIKOJNË NË CENIMIN E SIGURISË DHE PËRHAPJEN E DHUNËS NË SHKOLLË

- NGRËHTËSIA DHE MBIKËQYRJA E FËMIJËS NGA PRINDËRIT
- NDËSHKIMI FIZIK NDAJ FËMIJËS DHE SHPËRTHIMI EMOCIONAL I DHUNSHËM NGA ANA E PRINDËRVE
- TEMPERAMENTI I FËMIJËS
- LIDHJA E DOBËT: MËSUES-NXËNËS-PRINDËR
- MUNGESA E KODIT TË SJELLJES DHE ETIKËS SË NXËNËSVE
- RRJETET SOCIALE TË PAKONTROLLUARA, ETJ.

SI MUND TË PARANDALOJMË KËTË DUKURI?

- LAJMËRONI MËSIMDHËNËSIN, PSIKOLOGUN APO PEDAGOGUN E SHKOLLËS
- LAJMËRONI DREJTORIN/EN E SHKOLLËS
- LAJMËRONI POLICINË
- BASHKËBISEDIMI ME PRINDIN APO KUJDESTARIN TUAJ
- FUSHATAT VETËDIJËSUESE, ETJ.



LAJMËRO BULLIZMIN !

LAJMËRO PËRDORIMIN E NARKOTIKËVE !

LAJMËRO DHUNËN NË FAMILJE !